

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot 07.08.2018, pjesët në vijim e përfundojnë këtë kontratë si më poshtë:

Dorjan Balla identifikuar me numer dokumenti identifikimi nr. I70307081I, lindur me 07.03.1987 ne Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e ortakut te shoqerise WGEST GROUP shpk, zoterues i nje kuote te barabarte me 50% te kapitalit themeltar te shoqerise te barabarte me 50.000 lek;

Gianfranco Ciccone identifikuar me numer dokumenti identifikimi nr. AR2421050, lindur me 25.07.1964 ne Campobasso, dhe banues ne Campobasso, zoterues i nje kuote te barabarte me 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, te barabarte me 50.000 lek,

dhe

Haxhi Haka identifikuar me numer dokumenti identifikimi nr. J10525101D, lindur me 25.05.1991 ne Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar;

Personat juridikë të sipërpërmendur janë të gatshëm të hyjnë në këtë Marrëveshje në kushtet e mëposhtme:

Shitja e aksioneve

Dorjan Balla, transferon një kuote te barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise ne vleren nominale 50.000 leke tek Haxhi Haka.


Gianfranco Ciccone transferon nje kuote te barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise ne vleren nominale 50.000 leke tek Haxhi Haka.

Trasferuesit (Shitesit) e kuotave tek blesesi, me te dhenat e sipercituara më lart, i cili pranon se e njeh gjendjen ekonomike dhe financiare të kompanisë, per cfare paraqesin librat kontabel, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, regjistrin te vendimeve te ortakeve te shoqerise, gjendja e furnitoreve dhe klienteve, punonjësit dhe gjithë palet e tjera për sa i përket zërave kontabël të shoqërisë, i cili bëhet pronar i një kuote, ekuivalente ne vlere nominale 100.000 lekësh, te barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise.

Cmimi i shitjes se kuotes

Cmimi i shitjes se kuotes eshte 50.000 leke per secilen kuote, detyrim ndaj Shitesit Dorjan Balla ne vleren 50.000 leke dhe detyrim ndaj Gianfranco Ciccone ne vleren 50.000 leke, secilit ortak qe shet kuoten e vet, e cila paguhet perpara nenshkrimit te kesaj kontrate me para ne dore.

Deklaratat dhe garancitë e palëve



Duke marrë parasysh këtë kontratë të shitjes së kuotes, gjendjen ekonomike dhe financiare të kompanisë dhe aktet nënligjore, sot, palët paraqesin deklaratat dhe garancitë si në vijim:

Statusi ligjor dhe autoriteti; Kompania është e përfshirë dhe vepron normalisht në përputhje me legjislacionin shqiptar sipas detyrimeve ligjore, Ligji nr.9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë", dhe ndryshimet e tij, ka të drejtën e plotë për të ushtruar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjet që rregullojnë funksionimin e saj.

Statusi i aktivitetit të Shoqërisë; Shoqëria nuk është në proces falimentimi, likuidimi, vullnetar apo jo. Kompania është aktive dhe vepron normalisht në sektorin e saj primar të akomodimit.

Kompania nuk ka marka të regjistruara në regjistrin e markave kombëtare ose ndërkombëtare;

Kompania nuk ka filiale, degë apo zotërime në kompani të tjera në Shqipëri ose jashtë saj.

Në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Blerësi merr përsipër përgjegjësitë në kushtet aktuale të shoqërisë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, dhe është përgjegjës për gjendjen e shoqërisë ndaj palëve të treta edhe për detyrimet që rrjedhin nga e kaluara sikurse edhe për pas nënshkrimit të kësaj kontrate përfaqëson nga pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë - Administratori

Kuotat e shoqërisë ishin dy dhe behen një duke qenë një ortak i vdetem.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 LEK. Administratori i vetëm i shoqërisë mbetet dhe nuk ndryshon, personi të cilit i janë caktuar kompetencat e përfaqësimit dhe administrimit të shoqërisë, z. Haxhi Haka.

Nënshkrimi dhe ekzekutimi i kontratës nga blerësi, nuk bie në kundërshtim ose nuk përbën shkelje të ndonjë ligji, të aktit rregullativ të aplikueshëm dhe të dispozitave të akteve nënligjore në fuqi. Për çdo mosmarrëveshje, palët zgjedhin gjykatën e Tiranës.

Kjo kontratë është përpiluar në tri kopje të së njëjtës vlerë ligjore, në shqip në 2 fletë perkthyer për shtetasin Italian nga Edmir Dano.

Blerësi

Haxhi Haka (EMER/MBIEMER/FIRME)

Shitës

GIANFRANCO CROONE
DORJAN BALLA (EMER/MBIEMER/FIRME)

Perkthyer nga:

Edmir Dano (EMER/MBIEMER/FIRME)